



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
DREJTORIA E ARSIMIT, RINISË DHE SPORTEVE  
SEKTORI I ARSIMIT PARASHKOLLOR

Nr. 7135 Prot

Lezhë, më 20.05.2024

**PROÇESVERBAL PËR KONSULTIMIN PUBLIK “PËR MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK VENDOR PËR RININË 2024-2027 BASHKIA LEZHË”**

**PRANË AMBJENTEVE TE BIBLIOTEKËS SË QYTETIT LEZHE DATË 15.05.2024**

**LEZHË**

I mbajtur sot me datë 15.05.2024, konsultim publik për miratimin e “Planit Strategjik Vendor Pë Rininë 2024-2027 Bashkia Lezhë”, sipas njoftimit të publikuar në faqen ËEB-it të Bashkisë Lezhë, në linkun si vijon: <https://lezha.gov.al/per-organizmin-e-degjeses-publike-ne-lidhje-me-miratimin-e-planit-strategjik-vendor-per-rinine-2024-2027-bashkia-lezhe/>


Takimi filloi me prezantimin e planit në disa pika përmbledhëse ku qëllimi i këtij plani është vendosja e rinisë në fokus të jetës aktive në Bashkinë Lezhë. Problematikat kryesore që u diskutuan ishin

- Ofrimi i mundësive dhe kushteve për të evituar largimin e të rinjve nga vendi i tyre.
- Angazhimi i të rinjve pas procesit mësimor në aktivitete të organizuara nga Bashkia Lezhë dhe organizata rinore në territorin e Bashkisë Lezhë.
- Bashkëpunime me institucionet arsimore dhe organizatat rinore për ndalimin e femnomeneve të rrezikshme sociale për të rinjtë.
- Mbështetja financiar dhe punësimi i të rinjve.
- Aktivitetet të ndryshme me të rinjtë pranë Qendrës Rinore Lezhë.
- Vendosja e një buxheti për këtë plan strategjik.
- Shërbime falas për të rinjtë e kategorive vunerabël
- Mungesa e transportit publik, i cili sjell kufizime të të rinjve në zonat rurale. Shfaqet nevoja për transport publik me orare fikse.
- Kalendar dhe plan i detajuar zbatimi mbi këtë plan dhe të ketë një zë të veçantë në buxhetin e Bashkisë Lezhë.

Të pranishëm në këtë konsultim publik ishin përfaqësues nga Këshilli Bashkiak Lezhë, përfaqësues të Organizatave Rinore dhe për të rinjtë , të rinj dhe përfaqësues nga Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve Bashkia Lezhë.

Takimi zgjati për më shumë se një orë nga ku u shoqërua me diskutime të ndryshme nga përfaqësuesit e organizatave që operojnë në Bashkinë Lezhë.

Mbajti Proçesverbal : Klodjana Rakaj



**Dëgjesa publike për “Planin Strategjik Vendor për Rininë 2024-2027, Bashkia Lezhë” , në Lezhë**



